



Republika e Kosovës /  
Komuna e Podujevës

Republika Kosova /  
Opština Podujevo



Republic of Kosova  
Municipality of Podujeva

## Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Nr. \_\_\_\_\_

Data. 16.10.2020

Podujevë,

Në bazë të Nenit 7 pika 2 nënpika 2.2 dhe Neni 15 pika 2 nënpika 2.3 ,të Ligjit për Transportin Rrugor Nr.04/L-179, Neni 19 pika 1.6 dhe 1.14 e Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, Neni 8 i Rregullorës për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës nr.01/82/110 të datës 29 prill 2011, Neni 7 dhe Neni 8 i Rregullores për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Taksi të Udhëtarëve, nr. 01/116-110, të datës 30.06.2011, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim shpall:

### K O N K U R S

## PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT "TAXI" DHE „RADIO-TAXI” TË UDHËTARËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

### KUSHTET PËR APLIKIM

#### A) Transporti taksi i udhëtarëve-personat fizik:

- të ketë vendbanim në territorin e Komunës së Podujevës
- të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari,
- të ketë fotokopjen e policës së sigurimit
- të ketë lejen e drejtuesit të kategorisë „B”
- të ketë së paku 2 (dy) vite patentë shofer
- të ketë biznesin e regjistruar
- të ketë shkollën e mesme të kryer
- të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për "TAXI" drejtues
- të ketë dëshmi mbi kryerjen e obligimeve mbi taksën komunale
- të ketë certifikatën mjekësore
- të ketë njohuri për qytetin

Automjeti, përveç kushteve tjera të përcaktuara me ligj, duhet të plotësojë edhe këto kushte:

- të ketë së paku katër (4) dyer
- të ketë më së shumti 4+1 ulëse

- të ketë taximetrin
- të ketë të vendosur mbi automjetet shenjën "TAXI", e cila duhet të ndriçojë natën
- automjeti të mos jetë më i vjetër se 10 vjet

*Vërejtje: Numri i auto-taxive është i kufizuar në dhjetë (10) dhe përzgjedhja do të bëhet sipas kriterëve*

Kërkesa-Aplikacionet mirren dhe dorëzohen në zyrën pritëse, të adresuara për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.  
Konkursi mbetet i hapur 21 ditë nga dita e shpalljes në gazetë.

## **B) Transporti taksi i udhëtarëve –ndërmarrja "RADIO-TAXI"**

- të ketë licencë për këtë lloj transporti
- të ketë selinë në territorin e Komunës së Podujevës
- të ketë certifikatën e regjistrimit të biznesit
- të ketë së paku 10 automjete në pronësi, të cilat duhet të jenë me ngjyrë të njëjtë
- të ketë së paku dhjetë (10) shofer të punësuar, të cilët posedojnë lejen e drejtuesit të automjetit, të kategorisë „B”, më të vjetër se 2 vite
- të ketë vendqëndrim dhe sistemin e radiolidhjeve
- të ketë librezën e qarkullimit
- fotokopjen e policës së sigurimit
- certifikatat mjekësore për shoferët
- të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për "TAXI" ose "RADIO-TAXI" drejtues
- të ketë dëshmi mbi kryerjen e obligimeve mbi taksën komunale.

Aplikacionet mirren dhe dorëzohen në Zyrën Pritëse, të adresuar për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.  
Konkursi mbetet i hapur 21 ditë nga dita e shpalljes.

*Vërejtje: numri i kompanive "Radio-Taxi" është i kufizuar në dy (2) dhe përzgjedhja do të bëhet sipas kriterëve.*

**C) Kompanitë e licensuara "Radio-Taxi" dhe me leje veprimi brenda territorit të Komunës së Podujevës, në kushte të njëjta mund të aplikojnë për shtim të Automjeteve deri në 5 automjete.**

Drejtori  
Faik Muçiqi

